

MARRËVESHJE FINANCIARE

për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Ndër-rajonal IPA Greqi - Shqipëri 2014-2020

CCI 2014TC16I5CB010

KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian që në vijim referohet si "**Komisioni**", i cili vepron në emër të Bashkimit Evropian që më poshtë referohet si "**Bashkimi**",

nga njëra anë dhe

Republika e Shqipërisë, në vijim referuar si "Përfituesi i IPA II", e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë,

nga ana tjetër,

Republika Greke, e përfaqësuar nga Autoriteti Menaxhues i Programeve ETC, i Ministrisë së Ekonomisë, Zhvillimit dhe Turizmit,

nga ana e tyre,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 - Programi

- (1) Bashkimi është dakord të financojë dhe përfituesi i IPA II pranon financimin e programit të mëposhtëm të bashkëpunimit ndërkufitar siç përcaktohet në Shtojcën I dhe të miratuar me Vendimin e Komisionit të Zbatimit C (2015) 5482 të datës 30-7-2015:

IPA Ndër-rajonal Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020

CCI 2014TC16I5CB010

në vijim referuar si "Programi".

- (2) Ky Program financohet nga Buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim:

Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 mars 2014, për krijimin e një Instrumenti për Ndihmën e Para-anëtarësimin (IPA II)¹ (Rregullorja e IPA II, "IPA II");

- (3) Kostoja totale e parashikuar e programit është **42 312 029 EURO** dhe kontributi maksimal i Bashkimit në kuadër të Programit IPA II është vendosur të jetë **35 965 222 EURO** prej të cilave **17 982 611 EURO** si kontribut nga Kreu 4.

Kontributi i Bashkimit do të ndahet në detyrime financiare vjetore, në përputhje me Shtojcën I. Asgjë në këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të interpretohet se nënkupton një detyrim financiar të BE-së në lidhje me kreditë që ende nuk janë miratuar nga buxheti i BE-së. Komisioni duhet të informojë me shkrim autoritetin drejtues në lidhje me miratimin e çdo detyrimi financiar vjetor të dhënë në Shtojcën II.

Programi kërkon kontribute financiare si nga përfituesi i IPA II dhe nga Bashkimi. Ndarja e kontributeve përkatëse financiare është përcaktuar në Aneksin III.

Neni 2 - Periudha e ekzekutimit dhe periudha e pranimit

- (1) Periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financiare fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare dhe do të përfundojë 12 vjet pas kësaj date.
- (2) Shpenzimet e përfituesit të IPA II do të jenë të pranueshme për financim nën asistencën IPA II në qoftë se janë shkaktuar nga një përfitues përfundimtar i përfituesve të IPA II dhe paguhen pas dorëzimit të Programit, d.m.th. pas datës 22-9-2014 dhe para 31 dhjetorit 2023.

Neni 3 - Interpretim

- (1) Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe anekseve të saj do të interpretohen si plotësuese dhe shtesa të dispozitave të kuadrit rregullator të parashikuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje.
- (2) Nëse ka kontradikta në dispozitat e Kushteve të Veçanta të kësaj Marrëveshjeje dhe në Anekset e saj, dhe në veçanti në dispozitat në Aneksin IV ("Kushtet e Përgjithshme"), do të kenë përparësi dispozitat e përfshira në Kushtet e Veçanta të kësaj Marrëveshjeje.
- (3) Në bazë të ndonjë dispozite të caktuar në kundërshtim me këtë Marrëveshje, termat e përdorura në këtë Marrëveshje do të kenë të njëjtin kuptim siç u atribuohet atyre në aktet themelore të renditura në Nenin 1 (2).

¹ OJ L 77, 15.03.2014, fq. 11.

- (4) Në bazë të ndonjë dispozite të caktuar në kundërshtim me këtë Marrëveshje, referimet që i bëhen kësaj Marrëveshje janë referime ndaj kësaj Marrëveshjeje të ndryshuar, të plotësuar apo të zëvendësuar herë pas here.
- (5) Në bazë të ndonjë dispozite të caktuar në kundërshtim me këtë Marrëveshje, referimet që i bëhen kësaj Marrëveshje janë referime ndaj kësaj Marrëveshjeje të ndryshuar, të plotësuar apo të zëvendësuar herë pas here.
- (6) Titujt në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

Neni 4 - Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimshme

- (1) Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse kjo Marrëveshje përmban mangësi të paqëllimshme, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme e cila do jetë sa më afër të jetë e mundur me qëllimin dhe synimin që kishte dispozita e pavlefshme.
- (2) Palët do të plotësojnë çdo mangësi të paqëllimshme me një dispozitë e cila i përshtatet më mirë qëllimit dhe synimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me kuadrin rregullator.

Neni 5 - Adresat dhe Komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje financimi duhet të jetë në formë të shkruar, do të referohet shprehimisht Programit siç identifikohet në nenin 1 (1) dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

(a) **për Komisionin**

Komisioni Evropian

Drejtoria e Përgjithshme për Politikën Rajonale dhe Urbane

1049 Bruksel – Belgjikë

E-mail:

REGIO-TRANSNATIONAL-AND-INTERREGIONAL-COOPERATION@ec.europa.eu

(b) **për përfituesin e IPA II**

Daniela Çekani, Sekretare e Përgjithshme

Ministria e Integrimit Evropian

Departamenti për Bashkëpunim Territorial

Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Sheshi Nënë Tereza 1010, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 4 228645

E-mail: daniela.cekani@integrimi.gov.al; ana.xhilaga@integrimi.gov.al

(c) për Republikën e Greqisë

Autoriteti Menaxhues i Programeve ETC,
Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit
65 Georgikis Scholis Ave, 57001, Selanik, Greqi
Tel: 00302310 469600, -604, Faks: +30 2310 469602
E-mail: interreg@mou.gr

Neni 6 - Marrëveshja Kuadër

Në përputhje me nenin 8 (5) të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Europian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015 (më poshtë e referuar si "Marrëveshja Kuadër"), rregullat për zbatimin e programit përcaktohen në këtë Marrëveshje Financimi. Rrjedhimisht, Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Financiare ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje Financimi do të plotësohet me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër, në veçanti kur kjo Marrëveshje Financimi nuk përmban dispozita të veçanta mbi një çështje të caktuar.

Në rast konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe, nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër, kjo e fundit do të ketë përparësi.

Neni 7 - Shtojcat

(1) Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:

(a) këto Kushte të Veçanta;

(b) Shtojcat e mëposhtme të cilat përbëjnë pjesë integrale të saj:

- i. Shtojca I: programi i bashkëpunimit IPA-CBC;
- ii. Shtojca II: plani financiar (detyrimet financiare vjetore të pjesshme);
- iii. Shtojca III: plani financiar (kontributet financiare të pjesshme nga Bashkimi dhe përfituesit e IPA II, përfituesit për akset prioritare);
- iv. Shtojca IV: Kushtet e Përgjithshme;
- v. Shtojca V: Marrëveshja dypalëshe midis Republikës së Greqisë dhe përfituesve të IPA II në lidhje me marrëdhënien për zbatimin, menaxhimin dhe kontrollin e Programit.

(2) Në rast të një konflikti, në njërin anë e dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër e dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi.

Në rast të një konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të Shtojcave dhe nga ana tjetër të dispozitave të këtyre Kushteve të Veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 8 - Dispozitat plotësuese të Shtojcës IV

Dispozitat plotësuese të Shtojcës IV

- (a) në plotësim të nenit 11 (2) të Shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse në Program nuk kanë rënë dakord për rregulla dhe kushte të veçanta për zhvillim lokal të drejtuar nga komuniteti, plane veprimi të përbashkëta dhe investime të integruara territoriale pasi Programi nuk i parashikon këto veprime;
- (b) në plotësim të nenit 34 (1) të Shtojcës IV, këto Kushte të veçanta nuk do ta lejojnë pjesëmarrjen në thirrjen për propozime të subjekteve pa personalitet juridik;
- (c) në plotësim të nenit 34 (5) të Shtojcës IV, kriteret pranimit të përcaktuara në këtë nen nuk kufizohen në lidhje me kombësinë, vendndodhjen gjeografike apo natyrën e aplikantëve;
- (d) në plotësim të nenit 37 (4) të Shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse në Program nuk kanë përcaktuar autoritetin e vetëm menaxhues për të kryer funksionet e autoritetit certifikues;
- (e) në plotësim të nenit 42 (3) të Shtojcës IV, përfituesi i IPA II nuk e ka autorizuar autoritetin e auditimit për të kryer drejtpërdrejt funksionet e parashikuara në nenin 127 të Rregullores (BE) Nr. 1303/2013 në të gjithë territorin e mbuluar nga një Program bashkëpunimi;
- (f) në plotësim të nenit 45 të Shtojcës IV, koordinatori kombëtar i IPA-s ja ka deleguar rolin e tij drejtues për koordinimin e pjesëmarrjes së përfituesit të IPA II në programet përkatëse ndërkufitare, Strukturës operative të Bashkëpunimit Territorial, në Ministrinë e Integritimit Evropian;
- (g) në plotësim të nenit 49 të Shtojcës IV, shkalla e bashkëfinancimit dhe shuma maksimale e ndihmës IPA II bazohet në shpenzimet totale të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private;
- (h) në plotësim të nenit 57 (3) të Shtojcës IV, metoda e zgjedhur për këtë Program është ajo e përmendur në pikën (a) të nënparagrafit të parë të këtij Neni;
- (i) në plotësim të nenit 73 (3) të Shtojcës IV, vendet pjesëmarrëse kanë vendosur për të mos e rimarrë shumën e paguar tepër nëse shuma që do të mbulohet nga përfituesi, pa përfshirë interesin, nuk i kalon 250 Euro kontribut nga ndihma e IPA II.

Neni 9 - Marrëveshja dypalëshe Shtesë

Republika e Greqisë dhe përfituesi i IPA II kanë rënë dakord që masat e detajuara midis tyre do të jenë pjesë e kësaj Marrëveshjeje financimi në formë Shtojce V, duke përcaktuar një marrëveshje shtesë dypalëshe ndërmjet tyre.

Kjo Marrëveshje dypalëshe do të përcaktojë në veçanti rregulla që rregullojnë marrëdhëniet përkatëse midis autoritetit menaxhues (duke përfshirë sekretariatit teknik), autoritetin çertifikues dhe autoritetin auditues të Programit dhe autoritetet përkatëse të përfituesve IPA II.

Kjo Marrëveshje Dypalëshe është e detyrueshme ligjrisht vetëm në Republikën Greke dhe përfituesin e IPA II dhe si rrjedhojë, do të nënshkruhet vetëm nga ana e tyre.

Neni 10 - Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi në datën kur Komisioni do të njoftohet nga përfituesit e IPA II për konfirmimin e përfundimit të procedurave të brendshme të përfituesit të IPA II, të cilat janë të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi. Komisioni do të informojë përfituesin e IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Kjo Marrëveshje Financimi është hartuar në tre modele në gjuhën angleze, një që i është dorëzuar Komisionit, një Republikës së Shqipërisë dhe një Republikës së Greqisë.

Për Republikën e Shqipërisë:

Znj. Klajda Gjosa

Ministre e Integritimit Evropian

Koordinatori Kombëtar i IPA-s

Nënshkrimi

Tiranë, data

Për Komisionin:

Walter Deffaa

Drejtori i Përgjithshëm DG REGIO

Nënshkrimi

Bruksel, data

Për Republikën e Greqisë:

Z. Georgios Stathakis

Ministër i Ekonomisë,

Zhvillimit dhe Turizmit

Nënshkrimi

Vendi, data